

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6742  
E enjte, 27 tetor 2022  
çmimi 0.40 €

## Qeveria ndan 4 milionë euro për blerjen e barnave esenciale



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## OSMANI MOHON SE KA PRESION NGA NDËRKOMBËTARËT PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR TARGAT



Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka mohuar të mërkurën se ka presion ndërkombëtar për shtyrjen e afatit për konvertimin e targave të veturave serbe në RKS. "Unë nuk do ta quaja presion. Gjithçka që vjen nga miqtë tanë është sugjerim me qëllimin më të mirë të mundshëm.

Natyrisht që sikurse ne si liderë institucionale të Kosovës, ashtu edhe miqtë tanë qëllimin e kanë të ruhen paqja dhe stabiliteti në Kosovë e përtej", ka pohuar Osmani. Afati për reregjistrim të makinave në RKS ka nisur më 1 shtator dhe përfundon më 31 tetor

## IKSHPK-ja NJOFTON PËR DY VARIANTE TË REJA TË KORONAVIRUSIT



KRASNIQI I FTON TË RINJTË T'I BASHKOHEN PLATFORMËS "RINIA 2022"

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

## QEVERIA THOTË SE ATK-ja KA PËRMIRËSUAR INKASIMIN E TË HYRAVE

## MINISTRIA E FINANCAVE HAP THIRRJEN PËR APLIKIM PËR PUNË PRAKTIKE PËR 100 TË RINJ

## SPORT



PRESIDENTI ADEMI PARAQET PROJEKTET E FFK-SË NË KOMITETIN HATTRICK

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Banka Botërore: Ndhimja për secilin për fatura të energjisë kushton shtrenjtë

WASHINGTON, 26 TETOR - Banka Botërore ka paralajmëruar se qeverive u kushton shumë shtrenjtë që t'i ndihmojnë secilit për shkak të rritjes së faturave të energjisë. Presidenti i Bankës Botërore, David Malpass, ka thënë se skemat për mbështetje në kohën e pandemisë së koronavirusit nuk kanë shënjestruar më të cenueshmit dhe se shlyerja e borxhit do të marrë kohë me dekada. Sipas tij, politika të ngjashme janë duke u miratuar për t'u ndihmuar njerëzve pas rritjes së çmimeve të energjisë. "Qeveritë janë duke thënë se do të kujdesemi për secilin, diçka që do të jetë shumë e shtrenjtë", ka thënë ai. Instituti për Financa Ndërkombëtare ka thënë se borxhi global ka arritur në 305 trilionë dollarë më herët gjatë këtij viti dhe pritet të rritet edhe më shumë. Lufta e Rusisë në Ukrainë është

duke shkaktuar rritje të mëtejme të çmimeve të energjisë. Një për gjithë Evropën qeveritë janë duke paraqitur masa për t'u ndihmuar ekonomive familjare teksa përballen me rritje të tilla. Kriza me energji vjen në kohën kur qeveritë tashmë kanë borxhe të mëdha për të paguar. Malpass ka thënë se është i shqetësuar se ndihma shtesë do të ndikojë në rritje edhe më të madhe të inflacionit. Fondi Monetar Ndërkombëtar pret që inflacioni global të ketë pikun në 9.5 për qind dhe se kjo shifër nuk do të nisë të ulet deri më 2024. Perëndimi beson se Rusia është duke përdorur furnizimet me energji si armë, pas sanksioneve që i janë vënë Moskës për nisje të luftës në Ukrainë. Kremlin, në anën tjetër, hedh poshtë këto akuza. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.



Presidenti rus, Vladimir Putin, e konsideron luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Protestë në Republikën Sërpska kundër rinumërimit të votave



BANJA-LLUKË, 26 TETOR - Mbështetësit e koalicionit qeverisës në Republikën Sërpska kanë protestuar më 25 tetor në Banja-Llukë, duke kërkuar që autoritetet zgjedhore t'i japin fund rinumërimit të votave për president. Republika Sërpska është një prej tri entiteteve në Bosnjë-Hercegovinë. Zgjedhjet e përgjithshme në këtë shtet u mbajtën gjatë këtij muaji. Millorad Dodik, lideri de fakto i serbëve të Bosnjës dhe president i partisë më të madhe në Republikën Sërpska, Aleanca

e Socialdemokratëve të Pavarur, udhëhoqi protestën, në të cilën, sipas policisë, morën pjesë 30 000 persona. Protestuesit mbanin fotografi të Dodikut dhe valëvitën flamujt partiakë, duke akuzuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se po tenton ta zhbëjë vullnetin e serbëve për ta zgjedhur Dodikun lider të tyre. Gjatë fjalimit para protestuesve, Dodik u zotua se do të luftojë për të drejtën e serbëve "për të zgjedhur se si duan të jetojnë" dhe akuzoi politikanët perëndimorë dhe ata joserbë në Bosnjë për "urrejtje" dhe se po

tentojnë "ta zhdukin" Republikën Sërpska. "Ne nuk do të heqim dorë nga liria jonë për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur", tha Dodik, partia e të cilit po kundërshton rinumërimin e votave. "Unë besoj fuqishëm në idenë e një Republike Sërpska të pavarur", shtoi ai. Protesta u nxit pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi t'i rinumërojë votat e zgjedhjeve të përgjithshme të mbajtura më 2 tetor. Rinumërimi po bëhet për zgjedhjet për president dhe nënpresident në Republikën Sërpska.

## Gjermania drejt legalizimit të kanabisit

Berlin, 26 tetor - Gjermania i ka hapur rrugë legalizimit të blerjes dhe posedimit të sasive të vogla të marijuanës për përdorim rekreativ, por edhe për prodhim. "Qeveria federale sot u pajtua për pikat kyçe sa i përket shpërndarjes së kontrolluar të kanabisit për të rritur për përdorim rekreativ", tha ministri i Shëndetësisë, Karl Lauterbach, në një konferencë për medie më 26 tetor. Furnizimi dhe përdorimi i kanabisit pritet të "lejohet

përmes licencave të lëshuara dhe kontrolluara nga shteti", tha Lauterbach. Sipas këtij propozimi, personat mbi 18 vjeç do të lejohen të posedojnë "20 deri në 30 gramë" kanabis të tharë, që duhet të shitet në dyqanet e autorizuar dhe farmacitë. Gjermania, po ashtu, do ta lejojë prodhimin e kanabisit, por bizneset duhet të marrin leje për këtë, ndërkaq qytetarët do të lejohen që t'i rrisin tri bimë kanabis për përdorim vetjak. Sipas propozimit, nuk do të lejohen

reklamat për kanabis, ndërkaq paketimi i produkteve të kanabisit duhet të jetë "neutral". Lauterbach nuk tregoi datën e saktë se kur ky draftpropozim do të shndërrohet në ligj, por vlerësoi se legjislacioni mund të hyjë në fuqi më 2024. Vitin e kaluar Malta u bë shteti i parë në Evropë që zyrtarisht legalizoi kanabisin dhe kultivimin e tij për përdorim personal - edhe pse disa shtete të tjera kanë ligje liberale për këtë çështje.



# Qeveria ndan katër milionë euro për blerjen e barnave esenciale

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 TETOR - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje të rregullt të mërkurën në të cilën është bërë ndryshimi dhe plotësimi i programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2022. Sipas ndryshimeve të Programit Legjislativ, shtohen Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për provimin e maturës shtetërore, ndërkaq ndryshohet afati i miratimit nga qeveria për Projektligjin për shërbimin e jashtëm, Projektligjin për protokollin e shtetit dhe Projektligjin për diasporën.

Gjithashtu, kabineti qeveritar miratoi edhe tri projektligje: Projektligjin për Ekspertët Gjyqësorë, i cili përcakton kushtet dhe procedurat e licencimit të ekspertëve, subjekteve që kryejnë ekspertizën, të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirjen dhe shlyerjen e subjekteve që kryejnë ekspertizën në regjistër dhe mënyrat e angazhimit të tyre; Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konsumatorit i cili ka për qëllim harmonizimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe ta bëjë edhe më të zbatueshëm Ligjin për mbrojtje të konsumatorit dhe Projektligjin për Zhvillim Rajonal të Balancuar i cili është në përputhje me legjislacionin



evropian dhe përcakton parimet themelore të menaxhimit të zhvillimit rajonal. Ky projektligj përcakton edhe orientimet, përgjegjësitë e institucioneve, institucionet financiare dhe rregullat për zhvillimin e balancuar rajonal në Republikën e Kosovës.

Po në këtë mbledhje është themeluar edhe Këshilli Organizativ për shënimin e njëqindëdhjetëvjetorit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Kryesues i këtij këshilli është emëruar ministri i Kulturës, Rinisë

dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

Po ashtu, qeveria ndau mjete buxhetore në shumën prej katër milionë e dyqind mijë e njëqind (4,200,100.00) eurosh për blerjen e barnave nga lista esenciale sipas kërkesës së Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës. Gjithashtu, u bë ndryshimi dhe plotësimi i Vendimit nr. 31/99, i datës 30 shtator 2022, për masat shtesë të Pakos për Ringjalljen Ekonomike për Përballje me Inflacion.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe planin e veprimit 2022-2023

për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023. Plani liston objektivat, aktivitetet dhe financimin e tyre gjatë zbatimit në periudhën e caktuar kohore.

Kabineti qeveritar u informua nga ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal lidhur me koncept-dokumentin për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Grupi punues ka bërë

analizimin dhe rekomandimet e duhura për rregullimin e fushës, ndërkohë që Kuvendi i Kosovës ka themeluar një komision ad-hoc për reformën zgjedhore në Kosovë, e cila do të shtrihet edhe në nivelin lokal të qeverisjes. Nisur nga kjo situatë, koncept-dokumentin paraqitet në qeveri vetëm për informatë, derisa i njëjti do të dërgohet në komisionin ad-hoc të Kuvendit me qëllim të ndihmës së trajtimit të problemeve të identifikuara për procesin zgjedhor në nivelin lokal.

## Haxhiu thotë se Projektligji Civil së shpejti do të miratohet në Kuvend

PRISHTINË, 26 TETOR - Ministria e Drejtësisë së shpejti do ta dërgojë në Kuvend Projektligjin Civil, i cili, sipas drejtueses së kësaj ministre, do të miratohet.

Ministrja Albulena Haxhiu ka thënë se kanë zhvilluar takime me deputetët e grupit parlamentar të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, duke pranuar se disa prej tyre ende kanë "qëndrimet dhe bindjet e tyre", por ka shtuar se ky legjislacion kësaj radhe do të miratohet. "Unë nuk them në asnjë mënyrë që secili deputet i grupit parlamentar do të votojë për. Ka ende disa që i kanë qëndrimet dhe bindjet e tyre, por po them edhe një herë se qeveria dhe grupi parlamentar në shumicë angazhohet për avancimin e të drejtave të njeriut jo vetëm për hir tonin si shtet, por edhe për hir të proceseve në të cilat kemi aplikuar. Për shembull, aplikimi në Këshillin e Evropës është jashtëzakonisht i rëndësishëm për Kosovën dhe për t'u bërë anëtar, ju e dini se së pari duhet të respektohen të drejtat e njeriut", ka thënë Haxhiu në një konferencë për medie të mërkurën pas mbledhjes së qeverisë. Haxhiu nuk ka treguar se çfarë



ndryshimesh ka pësuar Projektligji Civil, pasi ka dështuar të miratohet më 16 mars, por ajo ka thënë se ndryshimet do të bëhen publike kur të kalojë nga

qeveria në Kuvend, duke shtuar se, përveç deputetëve të Vetëvendosjes, pret edhe përkrahjen e opozitës. Gjatë seancës plenare të 16 marsit

disa deputetë kanë kundërshtuar pjesën e legjislacionit që lejon "bashkësitë civile". Atëbotë edhe kërret e katër bashkësive fetare në Kosovë kanë kundërshtuar, siç ka

thënë, ndryshimin e përkufizimit të martesës. Në versionin e parë të Projektligjit thuhet se "martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht ndërmjet dy bashkëshortëve të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku si burrë e grua". Por, në nenin pasues theksohet se "bashkësitë e regjistruara civile ndërmjet personave me sekse të njëjta janë të lejuara" dhe se kushtet dhe procedura lidhur me këtë rregullohen me ligj të veçantë. Kushtetua e Kosovës thotë se "se në bazë të pëlqimit të lirë, çdokush gëzon të drejtën të martohet dhe të drejtën që të krijojë familje në pajtim me ligjin".

Në shtetet perëndimore bashkësitë civile nuk konsiderohen si martesë, por si marrëdhënie e ligjshme ndërmjet dy personave, që siguron mbrojtje ligjore për çiftin vetëm në nivel shtetëror.

Në Bashkimin Evropian bashkësitë civile lejojnë dy persona që jetojnë së bashku në çift, ta regjistrojnë marrëdhënien e tyre në autoritetin publik përkatës në vendbanimin e tyre. Dallime midis vendeve të BE-së në këtë fushë, po ashtu, ekzistojnë.



# Osmani mohon se ka presion nga ndërkombëtarët për shtyrjen e afatit për targat

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka mohuar të mërkurën se ka presion ndërkombëtar për shtyrjen e afatit për konvertimin e targave të veturave serbe në RKS. “Unë nuk do ta quaja presion. Gjithçka që vjen nga miqtë tanë është sugjerim me qëllimin më të mirë të mundshëm. Natyrisht që sikurse ne si liderë institucionalë të Kosovës, ashtu edhe miqtë tanë qëllimin e kanë të ruhen paqja dhe stabiliteti në Kosovë e përtej”, ka pohuar Osmani. Afati për reregjistrim të makinave në RKS ka nisur më 1 shtator dhe përfundon më 31 tetor

**Mal QORRAJ**

**EPOKA  
ERE**

Prishtinë, 26 tetor - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka mohuar se ka presion ndërkombëtar për shtyrjen e afatit për konvertimin e targave të veturave serbe në RKS. Ajo ka theksuar se në bashkëpunim me ta do të gjendet një zgjidhje me qëllim të sundimit të ligjit dhe që qytetarët serbë të mos ndihen të kërcënuar.

Osmani ka theksuar se çështja e shndërrimit të targave ilegale në ato RKS është përpjekje për sundim të ligjit. “Unë nuk do ta quaja presion. Gjithçka që vjen nga miqtë tanë është sugjerim me qëllimin më të mirë të mundshëm. Natyrisht që sikurse ne si liderë institucionalë të Kosovës, ashtu edhe miqtë tanë qëllimin e kanë të ruhen paqja dhe stabiliteti në Kosovë e përtej, kurse sa i përket qëndrimit tim rreth targave, e kam thënë para tri-katër ditësh, është i njëjti. Kjo është çështje e sundimit të ligjit dhe në koordinim me partnerët tanë do ta gjejmë një zgjidhje, ku qytetarët serbë nuk do të ndihen as të kërcënuar, as të frikësuar, sepse qëllimi është i mirë për ta. Natyrisht,

bashkërisht do t'i vazhdojmë përpjekjet tona për sundim të ligjit dhe për luftim të bandave kriminale të cilat po djegin shtëpi, po djegin makina e të tjera”, ka thënë Osmani. Kryetarja e shtetit, derisa ka marrë pjesë në mbjelljen e drunjve në aksin rrugor tek Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, ka shtuar se do të gjendet një zgjidhje e cila është përkitazi me afatin dhe mbron serbët e Kosovës. “Ne duhet të ulemi të gjejmë një zgjidhje të përbashkët ku edhe respektohen obligimet ligjore e kushtetuese që i kemi ne si institucione e, në anën tjetër, të gjithë serbët që jetojnë në Kosovë, ndihen të mbrojtur, të informuar dhe, po ashtu, imbrojmë ata nga kërcënimet e vazhdueshme që po ua bëjnë bandat kriminale serbe. Dhe besoj se do të gjendet një zgjidhje përpara e cila edhe e respekton afatin edhe i mbron serbët nga këto kërcënime të vazhdueshme”, ka shtuar Osmani. Një ditë më parë kryeministri Albin Kurti ka konfirmuar se nuk do të ketë shtyrje të afatit për targat. “Ne tashmë e kemi bërë një shtyrje të afatit më 31 korrik. E kemi shtyrë afatin për një muaj dhe në vend se të jetë data 1 tetor, është data 1

nëntor. Të gjithë qytetarët e Kosovës që kanë automjete me targa të kohës së Millosheviqit do të mund t'i konvertojnë ato në targa legale e legjitime - RKS”, ka thënë Kurti. Më tutje, Kurti u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve serbë që ta shfrytëzojnë kohën e mbetur për t'i konvertuar targat ilegale në RKS. “Fushata vazhdon përmes medieve, takimeve me të gjithë aktorët që targarat RKS të shtohen e ato KM të hiqen. Ne bëjmë më të mirën e mundshme duke mos kursyer energjinë. Këto nuk janë masa kundër serbëve, por për serbët. Jemi të interesuar që të gjithë të jemi të barabartë. Nuk është as hakmarrje, as inat, as urrejtje, por zbatim i ligjit. Kur aleatët e partnerët tanë na japin sugjerime, ne i marrim ato shumë seriozisht dhe i analizojmë me kujdes”, ka deklaruar Kurti.

Emisari special i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, javën e kaluar ka vizituar Kosovën, ku ka bërë me dije se i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës ta shtyjë edhe për 10 muaj afatin për konvertimin e targave. “Nuk është sekret që ne kemi kërkuar një periudhë më të gjatë të zbatimit dhe

kemi kërkuar edhe 10 muaj të tjerë. Do të doja ta shihja këtë që të ndodhte. Kjo nuk është vetëm kërkesë e ShBA-së, por e gjithë Quint-it. Dhe kjo është për shkak se ne jemi shteti që e përkrahim më së shumti Kosovën. Besojmë se është e rëndësishme që kur ne bëjmë rekomandime, njerëzit t'i dëgjojnë ato”, kishte thënë Escobar në një intervistë për “Kanal10”.

Edhe Bashkimi Evropian (BE) ka kërkuar që të shtyhet vendimi për targat serbe. Zëdhënësi i BE-së, Peter Stano, ka theksuar se kjo shtyrje do të mundësonte një fushatë informative dhe konsultime më thelbësore. Këto targa konsiderohen të paligjshme nga autoritetet në Kosovë, mirëpo deri më tani janë toleruar në veri të

Kosovës.

Më 31 korrik dhe 1 gusht serbët lokalë në veri të Kosovës kanë vendosur barrikada në shenjë pakënaqësie ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për zbatim të dy vendimeve: për targat e makinave dhe dokumentet serbe. Kosova dhe Serbia kanë nisur negociatat për normalizimin e marrëdhënieve më 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian.

Procesi i negociatave pritet të përfundojë me marrëveshje ligjrisht të detyrueshme.

Ndonëse Kosova deklaroi se kjo marrëveshje duhet ta përfshijë njohjen e ndërsjellë, Serbia nuk pranoi, duke insistuar në “zgjidhje kompromisi”.

## ShBA-ja synon që vendimi për targat të zbatohet në mënyrë paqësore

Shtetet e Bashkuara synojnë që vendimi i Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa serbe në RKS - Republika e Kosovës - të zbatohet në mënyrë paqësore, dhe të mos kontribuojë në rritje të tensioneve. Kështu ka thënë një zëdhënës i Ambasadës Amerikane në Prishtinë në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”. Mes të tjerash, Ambasada ka thënë se ShBA-ja, bashkë me partnerët evropianë, besojnë se vendimi i Qeverisë së Kosovës është në përputhje me marrëveshjet e Brukselit dhe se, në parim, nuk kanë mospajtime për të. “Megjithatë, ne kemi kërkuar, bashkë me partnerët tanë ndërkombëtarë, një shtyrje dhjetëmuajore për zbatim të vendimit”, është thënë në përgjigjen e Ambasadës së ShBA-së.

## Konjufca e Szunyog flasin për agjendën e reformave evropiane



PRISHTINË, 26 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të mërkurën në takim shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, ambasadorin Tomas Szunyog, nga i cili ka pranuar Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, publikuar më 12 tetor. Konjufca e ka njoftuar ambasadorin Szunyog përkitazi me punën e deritashme, arritjet,

planet dhe sfidat e legjislativës së VIII, teksa ka përmendur përmbushjen e konsiderueshme të agjendës legjislative, pastaj miratimin e Rregullores së re të Punës, pas më shumë se një dekade përpjekjesh, si dhe miratimin e disa ligjeve shumë të rëndësishme që lidhen me agjendën e reformave evropiane, që prej kohësh nuk kishin arritur të miratoheshin. “Është e

rëndësishme të theksohet fakti se Kuvendi vetëm gjatë sesionit pranveror të këtij viti ka arritur të miratojë 87 ligje, shifër kjo më e larta e arritur gjatë një sesioni”, ka thënë Konjufca.

Duke folur për Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, kryetari Konjufca vlerësoi se dokumenti në fjalë pasqyron përparimin e arritur si asnjëherë më parë dhe, po ashtu,

shërben si udhërrëfyes për institucionet shtetërore që të angazhohen edhe më shumë për përmbushjen e detyrave, sidomos në ato fusha ku mund të bëhet më shumë.

Më tutje, kryetari i Kuvendit ka njoftuar se në ditët në vijim do t'i shqyrtojnë dhe analizojnë gjetjet e raportit dhe përmes një plani të posaçëm veprimi do t'i adresojnë të gjitha të gjeturat, duke thënë se

Kuvendi i Republikës së Kosovës është i përkushtuar për t'i adresuar të gjitha rekomandimet e Komisionit Evropian.

Përfaqësuesi special i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog, shprehu gatishmërinë për shtimin e bashkëpunimit dhe për vazhdimin e mbështetjes të legjislativitetit në funksion të avancimit të agjendës së përbashkët evropiane.

## Ministri i Brendshëm i Çekisë konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

PRISHTINË, 26 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, gjatë qëndrimit të tij në Republikën e Çekisë, ku po merr pjesë në Ministerialin e Katërt të Procesit të Pragës, ka takuar zëvendëskryeministrin e parë dhe ministrin e Punëve të Brendshme të Çekisë, Vit Rakusan. Me këtë rast, ministri Sveçla ka falënderuar Rakusan për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës, sidomos për mbështetjen konkrete të Presidencës Çeke, për ta shtyrë përpara procesin e liberalizimit të vizave për Republikën e Kosovës.

Ministri Sveçla e ka njoftuar homologun e tij me prioritetet dhe rezultatet e arritura në fushën e luftimit të krimit e të korrupsionit, migrimit të paligjshëm dhe kontrabandës në përgjithësi, si dhe

angazhimin e Qeverisë së Kosovës për t'i shtyrë përpara proceset e integritetit evropian. Siç njofton MPB-ja, ministri Rakusan i ka përgëzuar institucionet e Kosovës për rezultatet e dukshme të arritura kohën e fundit në luftën kundër krimit dhe korrupsionit dhe ka konfirmuar përkrahjen e rezervë të Qeverisë së Republikës Çeke në proceset integruuese, përfshirë edhe procesin e liberalizimit të vizave.

Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që dy vendet kanë potencial shumë të madh për ta rritur bashkëpunimin në shumë fusha, veçan bashkëpunimin policor, shkëmbimin e informacioneve dhe fushave të tjera me interes të përbashkët për të kontribuar së bashku për sigurinë në rajon dhe më gjerë.



## Kryetari i Gjilanit zgjedhet kryesues i Bordit të AZhR-Lindje

**GJILAN, 26 TETOR** - Në mbledhjen e rregullt të Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal Lindje, të organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni, me votë unanime u zgjodh kryesues i Bordit të AZhR-Lindje. “Falënderoj kolegët kryetarë të komunave të rajonit Lindje dhe zotohem për thellimin e bashkëpunimit

ndërkomunal, gjithmonë në të mirën e përbashkët të qytetarëve të komunave që përfaqësojmë. Bashkë për zhvillimin rajonal!”, ka thënë Hyseni.

Bordi, po ashtu, miratoi raportin e punës të Agjencisë për vitin paraprak, derisa konkludim i këtij takimi ishte se AZhR-Lindje është mekanizëm i cili ka impakt të drejtpërdrejtë

në bashkëpunimin ndërkomunal dhe në zhvillimin rajonal.

Kryetarët e komunave u zotuan se do të jenë aktivë dhe mbështetës në kuadër të AZhR-Lindje, sepse kështu është një lidhje direkte në mes të orientimit të fondeve qeveritare, por edhe bashkëpunimit me donatorë dhe investitorë të fondeve ndërkombëtare.



## Kastrati nënshkruan kontratën për projektin më të madh zhvillimor për Malishevën urbane

**MALISHEVË, 26 TETOR** - Kryetari i komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati, ka nënshkruar kontratën për projektin fitues për ndërtimin e sheshit të dëshmorëve dhe transformimin e qendrës së qytetit në kuadër të projektit madhor për Malishevën urbane.

Kastrati nënshkrimin e këtij projekti e ka vlerësuar si të rëndësishëm së veçantë, për të cilin ka thënë se ky projekt është më i madhi dhe më i rëndësishmi në gjithë rrugëtimin zhvillimor të Malishevës. “Malisheva do të bëhet vërtet urbane me jetësimin e këtij projekti të jashtëzakonshëm. Qeverisja jonë do të vazhdojë të punojë fuqishëm derisa me punën tonë do të ndihet krenare Llapusha e shumë brezave”, ka thënë Kastrati.

Në fund, kryetari i komunës së Malishevës i ka uruar gjithë qytetarët e kësaj komune për këtë projekt shumë të madh zhvillimor.



## Totaj konfirmon përkrahjen për Kryqin e Kuq në Kosovë



**PRIZREN, 26 TETOR** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim kryetaren e Kryqit të Kuq të Kosovës, Feride Hyseni, sekretarin e përgjithshëm Agron Humolli, shefin e misionit të KNKK-së në Prishtinë, Agim Gashi dhe koordinatoren e bashkëpunimit në KNKK, Fikrie

Bexheti. Me këtë rast, u diskutua për aktivitetet që i zhvillon kjo organizatë humanitare dhe shqyrtuan mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen. Kryetari Totaj ka theksuar se komuna e Prizrenit do t'u qëndrojë afër njerëzve dhe organizatave të vullnetit të mirë në

çdo kohë, duke i dhënë mbështetje veprimtarisë humanitare në këtë komunë. “Misioni dhe veprimtaria e Kryqit të Kuq në Kosovë, në të gjitha etapat e historisë sonë, ka qenë sa fisnike, aq edhe informuese e vetëdijesuese për qytetarët”, ka thënë Totaj.

## Komuna e Skenderajt largon deponitë ilegale

**Skenderaj, 26 tetor** - Komuna e Skenderajt ka njoftuar nëpërmjet shërbimeve të saj publike se po angazhohet vazhdimisht për largimin e deponive ilegale. Kësisoj, në kuadër të përpjekjeve për ta zbatuar planin e punës, për një ambient të pastër në gjithë territorin e komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike është angazhuar të punojë për

largimin e deponive kudo që janë identifikuar ato.

Një aksion i tillë është ndërmarrë në fshatrat Polac dhe Kotorr, pas të cilave veprimet janë orientuar në Klinë të Epërme, përgjatë vendit të quajtur “Përroi i keq” dhe në Llaushë, ku janë pastruar hapësirat që ishin mbushur me mbeturina, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i

Shërbimeve Publike, Alban Shala.

Komuna e Skenderajt i ka njoftuar të gjithë qytetarët, pa dallim, që të kontribuojnë për mirëmbajtje të ambientit, duke mos hedhur mbeturina jashtë hapësirave që nuk janë të dedikuara, njëkohësisht fton për raportim tek organet kompetente, kudo që hasin në rastet e ndotjes së ambientit.



## Krasniqi i fton të rinjtë t'i bashkohen platformës "Rinia 2022"

PRISHTINË, 26 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, nëpërmjet një videoadresimi drejtuar të rinjve, i ka ftuar ata t'i bashkohen platformës "Rinia 2022". Ai ka thënë se rinia përmes angazhimit të hershëm politik mund të kontribuojë për t'i ndryshuar për të mirë gjërat në shoqëri. Si dikush që rrugëtimin politik e ka nisur si i ri, Krasniqi ka thënë se janë tri

gjëra që u garanton dhe të cilave ua njeh peshën për të rinjtë që i bashkohen PDK-së: Hapësirë për veprim, besim në angazhim dhe përgjegjësi në vendimmarrje. "Pas shpalljes së zgjedhjeve të brendshme të Rinisë Demokratike të Kosovës ne po lansojmë platformën digjitale rinia2022.org, ku secili mund të regjistroheni e të anëtarësoheni brenda 30 sekondave. Afati për t'u regjistruar dhe për t'u bërë

pjesë e procesit zgjedhor është deri më 20 nëntor", është shprehur kryetari i PDK-së.

Krasniqi ka thënë se Kosovës i duhen energjia, vullneti dhe besimi i rinisë për ta përshpejtuar rrugën e zhvillimit për të cilën aq shumë ka nevojë. "Secili që anëtarësohet do të jetë i barabartë në ndikim, duke garuar për përgjegjësi udhëheqëse, ose duke zgjedhur ata që besoni se do



t'u përfaqësojnë më së miri në krye të Rinisë Demokratike, në Degë, ose në Qendër. Klikoni në faqen rinia2022.org, plotësoni

formularin dhe bashkohuni me ne në rrugëtimin tonë të përbashkët për një Kosovë më të mirë!", ka thënë Krasniqi.

## IKShPK-ja njofton për dy variante të reja të koronavirusit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 26 tetor - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se Kosova po vazhdon të shënojë numër të vogël të rasteve të reja me Covid-19. Sipas këtij instituti, në vende të ndryshme të botës janë duke u regjistruar raste të shumta të Covid-19, sepse pandemia ende nuk ka mbaruar. "Sipas vlerësimit të fundit në ShBA, del se BQ.1 dhe BQ.1.1 janë të lidhur ngushtë dhe përbëjnë 16.6 për qind të varianteve të koronavirusit në vend, vlerë kjo e cila gati është dyfishuar nga java e kaluar, përderisa Evropa pret që ato të bëhen variantet dominuese brenda muajit të ardhshëm. Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve ka njoftuar se këto variante mund ta rrisin numrin e rasteve në javët dhe muajt e ardhshëm në rajonin evropian. Të dy variantet janë pasardhës të nënvariantit BA.5 të Omicron, i cili është forma dominuese e koronavirusit në Shtetet e Bashkuara. Rregullatorët në Evropë dhe ShBA kanë rekomanduar kohët e fundit dozat përforcuese të vaksinave", ka njoftuar IKShPK-ja.

Tutje në njoftim theksohet se, sipas zyrtarëve evropianë, nuk ka ende prova që BQ.1 është i lidhur me ashpërsi të shtuar të sëmundjes krahasuar me



variantet qarkulluese të Omicron BA.4 dhe BA.5, por paralajmëruan se mund të shmangë mbrojtjeje imunatare, duke përmendur studimet laboratorike në Azi. "Sipas virologëve dhe studiuesve të vaksinave, 'këto variante (BQ.1 dhe BQ.1.1) mund të çojnë në rritje të numrit të rasteve këtë dimër në ShBA dhe kjo rritje po

vërehet në Evropë dhe Mbretërinë e Bashkuar'. Organizata Botërore e Shëndetësisë këtë javë tha se BQ.1.1 po qarkullon në të paktën 29 vende. CDC e ShBA-së ka konfirmuar se BQ.1 dhe BQ.1.1 javën e kaluar u vlerësua se përbën 9.4 për qind të varianteve qarkulluese", thuhet në njoftim.

IKShPK-ja ka njoftuar se është duke vazhduar pandërprerë testimin dhe gjurmimin e të gjitha rasteve, kontakteve të rasteve në komunitet dhe diagnostikimin laboratorik. "Andaj të gjithë personat me kokëdhembje, kollitje, dhembje fyti, vështirësi në frymëmarrje, rrjedhje hundësh, temperaturë, plogështi, humbje të shijes,

rekomandohen të testohen. MSH dhe IKShPK u rekomandojnë qytetarëve që, përkundër situatës së qetë dhe stabile epidemiologjike në vend, të jenë të kujdesshëm në zbatimin e masave preventive kundër sëmundjeve ngjitëse dhe të vaksinohen kundër Covid-19", është theksuar në njoftimin e IKShPK-së.

## Realizohen mbi 2 000 koronarografi dhe 1 500 stentime në QKUK

PRISHTINË, 26 TETOR - Mbi 2 000 koronarografi dhe 1 500 stentime janë bërë nga fillimi i vitit e deri më tani në QKUK. Këto shifra u publikuan gjatë vizitës që ka bërë në Klinikën e Kardiologjisë, zëvendësuesja e ministrit të Shëndetësisë, Dafina Gexha. Drejtori i Klinikës së Kardiologjisë, Lulzim Kamberi, në kuadër të këtij takimi ka paraqitur punën që

po bëhet në klinikë dhe planet për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve. Sipas tij, klinika ka gjithsej 75 shtretër, 41 mjekë dhe 62 infermier/e që kanë bërë dhe po bëjnë punë të madhe, por nevojitet shtim i mëtejshëm i kapaciteteve hapësinore dhe investime në aparaturë.

Dafina Gexha, zëvendësuese e ministrit të Shëndetësisë, tha se Ministria e Shëndetësisë do

të ofrojë përkrahje për investime në aparaturë mjekësore, por edhe për zhvillim dhe avancim të shërbimeve kardiologjike. Ajo ka kërkuar që drejtuesit e klinikës, në bashkëpunim me Bordin Drejtues dhe menaxhmentin e ShSKUK-së, t'i bëjnë planifikimet e nevojshme për aparaturë dhe investime, projekte që do të përkrahen nga MSh-ja.



# Qeveria thotë se ATK-ja ka përmirësuar inkasimin e të hyrave

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 26 TETOR** - Kryeministri Albin Kurti ka marrë pjesë në Konferencën Rajonale për Përmirësimin e Menaxhimit të Borxhit Tatimor, organizuar në Kosovë nga CEF Qendra e Ekselencës Financiare, Sloveni, në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Administratën Tatimore të Kosovës dhe Administratën Tatimore të Holandës. Kryeministri Kurti, teksa shprehu kënaqësinë që sot ishte i pranishëm në këtë punëtori, tha se fakti që këto institucione të respektuara ndërkombëtare po e konsiderojnë Administratën Tatimore të Kosovës rast studimor për të mirë, tregon për përkushtimin, përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin në rritje të këtij institucioni. Duke folur për sukseset e

Administratës Tatimore të Kosovës, kryeministri theksoi se ky institucion ka përmirësuar inkasimin e të hyrave dhe se vetëm gjatë periudhës janar-shtator të vitit 2022 janë inkasuar 542.8 milionë euro tatime, që paraqesin të hyra rekord. "Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi rritje prej 95.8 milionë eurosh apo 21.4 për qind, ndërsa në krahasim me planin tonë kemi tejkalim të tij për 33.9 milionë euro apo 6.7 për qind", ka thënë kryeministri. Para të pranishmëve në këtë ngjarje, kryeministri Kurti përmendi edhe konsolidimin e funksionit të mbledhjes së borxheve si një ndër reformat më kryesore e cila ka ngritur thelbësisht cilësinë e menaxhimit të borxheve tatimore.

Kjo performancë pozitive, shtoi më tej ai, është rezultat i rritjes së disiplinës në Administratën Tatimore, numrit të inspektiveve dhe



rritjes së moralit tatimor apo motivit për t'i paguar taksat nga qytetarët. "Kur qytetarët dhe bizneset e shohin se institucionet nuk janë të

korruptuara dhe nuk e keqpërdorin dhe e ruajnë parandë publike, e shpenzojnë me kujdes dhe plan e me llogaridhënie, ata janë më të

gatshëm t'i paguajnë taksat, të bindur se ato pastaj do të përdoren për të mirën publike nëpërmjet shërbimeve publike", ka thënë Kurti.

## Ministrja Hajdari shkon në Greqi, interesohet për thellim të bashkëpunimit në ekonomi

**EPOKA E RE** **A. MAVRAJ**

**PRISHTINË, 26 TETOR** - Në kuadër të thellimit të raporteve të mëtutjeshme në mes të Kosovës dhe Greqisë, delegacioni i udhëhequr nga ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, në shoqërim nga drejtuesi i Zyrës së Interesave të Kosovës në Athinë, Fitim Gllareva, u pritën në takim nga përfaqësues të lartë të Greqisë.

Ministrja Hajdari u mirëprit në takim me ministrin Alternativ i Zhvillimit dhe Investimeve, Nikolaos Papatheanis, me kolegë. Në këtë takim produktiv palët reflektuan në portofolit e ministrive që udhëheqin, duke u kushtuar fokus të veçantë sektorëve industrialë dhe reformave të nevojshme strukturore për lehtësimin e të bërit biznes.

Ministrja Hajdari me Papatheanis shkëmbyen përvojat në fushën e investimeve strategjike për të cilën fushë pala greke ofroi



mbështetje institucionale përmes departamentit të investimeve strategjike dhe agjencisë ekzekutive Enterprise Greece. Në vijim ministrja Hajdari takoi zëvendësministren e Turizmit, Maria Zaharaki, me të cilën diskutuan për zhvillimet dhe

të arriturat në fushën e turizmit në Kosovë dhe Greqi dhe për mundësitë e zhvillimit të ofertave turistike me vendet e rajonit për përfitime të përbashkëta për të sjellë punësim, rritje të të ardhurave në Evropën Juglindore.

Zëvendësministria Zaharaki e shtjelloi rëndësinë që ka turizmi për zhvillimin ekonomik të Greqisë dhe paraqiti të gjitha programet turistike greke që kanë kontribuar në rritjen ekonomike. Palët u pajtuan që në të

ardhmen të bashkëpunojnë në projekte të përbashkëta turistike për Evropën Juglindore, me fokus në promovimin e vlerave të përbashkëta me kulturë të pasur dhe qytetërim të lashtë. Gjatë qëndrimit në Athinë, delegacioni i Kosovës u prit në takim edhe nga zëvendësministri i Punëve të Jashtme për Diplomacinë Ekonomike dhe Hapje, Kostas Fragogiannis, i cili theksoi rëndësinë për forcimin e lidhjeve ekonomike dhe tregtare në mes dy vendeve. Në këtë kontekst, ministrja Hajdari diskutoi me zëvendësministrin Fragogiannis për përparësitë e zgjerimit të marrëdhënieve ekonomike me Kosovën në sektorët industrialë në interes të përbashkët, për plotësim të furnizimeve të zinxhirit të vlerës në nivel rajonal dhe më gjerë.

Ministrja Hajdari e falënderoi zëvendësministrin Fragogiannis për mbështetjen politike të Greqisë për Kosovën gjatë proceseve të shtetndërtimit dhe anëtarësimit në organizata të rëndësishme euroatlantike.

## Ministria e Financave hap thirrjen për aplikim për punë praktike për 100 të rinj

**PRISHTINË, 26 TETOR** - Ministria e Financave ka njoftuar të mërkurën se ka hapur thirrje për aplikim në programin "Praktikë

në punë" për 100 të rinj të cilët do të angazhohen në qendrat për punë sociale, qendrat rezidenciale për të moshuar dhe

nevoja të veçanta, si dhe OJQ-të e licencuara nga MFPT-ja. Sipas njoftimit, kompensimi për këtë praktikë është 170 euro,

ndërkohë që kohëzgjatja e praktikës është gjashtë muaj. Thirrja është e hapur deri më 11 nëntor 2022.





# Ramiz Alia për vrasjen e “Çaushit” të Rumanisë: Gaboi, zgjodhi rrugën revizioniste!



**Nga: Vasil QESARI**

Sistemit socialist Lindor, po i vinte fundi ....! Shqipëria, megjithëse e quante veten jashtë kësaj loje, pësoi një goditje të rendit, sepse edhe ajo e kish pjesën e saj të diellit në atë sistem; për më tepër në kushte më të vështira ekonomike sesa gjithë vendet e tjera të Lindjes. Me situatën e krijuar, a mund të bëhej fjalë për ndonjë hap afrimi me vendet Perëndimorë? Ajo tezë dukej se qe djegur...!

Por, disa ide, fjalime e veprime të Ramiz Alisë, nisën të ngjallnin jo vetëm çudi e përshtjellime, por edhe shpresa për ndryshime. I ndërgjegjshëm për krizën e falimentimin e ekonomisë së vendit, në thelb, ai e kuptonte se edhe Shqipëria nuk do të mund t'i shpëtonte ndikimit të proceseve që zhvilloheshin në vendet lindore. Qe kjo arsyeja pse, disa lëvizje të kujdesshme të tij, krijuan në opinionin e brendshëm përshtypjen se vendi po tentonte të haptej. Por, në fakt, çdo hap e manovër, bëhej mbi të gjitha për mbrojtjen e pushtetit. Në fund të fundit, prej Ramiz Alisë e Byrosë Politike që e rrethonte, s'mund të pritej më tepër.

E, përveç kësaj, ai s'mund të shkelte mbi amanetet e komandantit! Por, megjithatë, ishte e nevojshme që diçka të

lëvizte. Në fund të 1987-ës, pas tri vizitash radhas të kryeministrit bavarez Franz Josef Strauss, mes Gjermanisë Federale e Shqipërisë u vendosën marrëdhënie diplomatike.

Ndërkohë, në gazetata e fjalimet zyrtare, referencat ndaj Marksit e Leninit nisën të mos citohen më. Ndërsa, në shkurt 1988, për herë të parë, Shqipëria mori pjesë në Konferencën Ballkanike të Ministrave të Jashtëm të organizuar në Beograd. Një muaj më pas, çuditërisht, u harrua të festohej përvjetori i vdekjes së Stalinit e, pak më vonë, në Tiranë u prit me nderime të mëdha Nëna e shquar Tereze ...!

Fjalët që qarkullonin poshtë e lart se, vendi po jepte shenja vullneti për hapje, se frymëzues e ideator i tyre qe Ramiz Alia, se në udhëheqjen e atrofizuar staliniste ai është i vetmi që mund të bënte ndryshime, se krahu konservator me në krye panterën e zezë, bënëin ç'ishte e mundur për ta penguar atë – të gjitha këto qenë tema të gjata bisedash, hamendjesh, shpresash e diskutimesh jo vetëm në qarqe intelektualësh e të rinjsh, por edhe në shtresa të caktuara të popullit e më gjerë. Por, me gjithë shpresat, punët në vend s'shkonin hiç mirë. I shqetësuar, në Plenumin e VIII-të të Komitetit Qendror, mbajtur

në shtator 1989, Ramiz Alia u mundua të justifikojë për gjendjen, duke ua hedhur fajin pasojave të situatave të turbullta në botë. Ndërkohë, përsa i përkiste situatës së brendshme, ai nuk citoi më frazat stereotipe euforike, por deklaroi se: vërtet ne nuk jetojmë në bollëk, por s'i kemi borxh askujt ...! Ne jemi krenarë për lirinë tonë, për pavarësinë e sovranitetin e vendit.

Por, këto fraza, tashmë, s'ngushëllonin kurrkënd. Sepse, vendin e ka pllakosur mizëria e uria. Në popull, pakënaqësitë shtohen e shprehen hapur. Tregu është bosh. Sigurimi i një racion mishi, është privilegj i madh. (Dalin fjalë se, çmimi i gomarëve në tregun e zi rritet dita-ditës për arsye se, shitet në vend të mishit të lopës). Gjendja ka vajtur aty ku s'mban e, Ramiz Alia, s'mund të bëjë gjë për ndryshimin e saj, përveçse t'u a hedhë fajin mekanizmave të kontrollit ekonomik, që nuk funksionojnë si duhet.

Presioni për ndryshime, për të gjetur rrugëdalje, për të bërë reforma, rritet. E, Ramiz Alia, bën sikur merr masa e vepron. Por, çdo lëvizje e tij është e pavendosur dhe e mangët. Natyrisht, ai as që ka ndër mend të bëhet Gorbaçovi i Shqipërisë! Ai s'mund të shkelë mbi betimin e Enver Hoxhës: “Ne hamë bar, por idealet s'i tradhetojmë”!

Ndërkohë, situatat në vendet e Evropës Lindore, evoluonin me ditë. Më 9 nëntor, u rrëzua murri famëkeq i Berlinit. Më tej, ngjarjet vazhduan sipas efektit domino, drejt Varshavës, Pragës, Budapestit ...! Po tani? Kush e kish radhën pas tyre?

!Radiot e televizionet e huaja njoftuan për konfrontime të përgjakshme të studentëve e punëtorëve me policinë në Timishora (Rumani). Për shtypjen e tyre, ushtria ndërhyu me dhunë. Pati të vrarë e të plagosur por, demonstruesit, dolën përsëri në rrugë. Në Shqipëri, njerëzit i drejtuan sytë tek lajmet e televizionit italian, i cili, herë pas here, jepte kronika nga ngjarjet. Shumëkush pyeste: Si do vinin punët vallë, në Rumani, në një vend i cili kishte mjaft pika të përbashkëta me diktaturën shqiptare? Si do përfundonin manifestimet? Si do reagonte Çaushesku...?

Më 20 dhjetor, në Timishoarë trazirat vazhdojnë e gjendja është tejet e nderë. Megjithatë, Çaushesku s'e ndërpret vizitën e planifikuar në Iran. Ai nisat me nxitim qysh në mëngjes herët. Po atë mbasdite, vizita përfundon e në mbrëmje njoftohet se presidenti do t'i drejtohet me një mesazh mbarë popullit nëpërmjet radiotelevizionit. Çaushesku, në përgjithësi, s'ka qenë kurrë ndonjë orator i zoti por, fjala e tij

mbajtur në natën e 20 dhjetorit qe vërtet më katastrofalja e gjithë karrierës së tij si burrë shteti.

Ai u paraqit në ekran në këmbë e me një cope letër në dorë, i filmuar në një zyrë të Komitetit Qendror. Nga njëra anë, fare pranë, zinin vend e shoqja Elena e kryeministri Daskalesku; në anën tjetër anëtarët e Byrosë Politike. Në fjalën e tij, Çaushesku iu shmang analizës së ngjarjeve në Timishoarë duke mos reshtur së hedhur rrufe mbi “tradhtarët” e vendit të cilët, në bashkëpunim me armiqtë e jashtëm, po kërcënonin tërësinë territoriale të atdheut socialist rumun.

Në mëngjesin e 21 dhjetorit, partia organizoi një miting solidariteti në sheshin para Komitetit Qendror. Militantët dhe aktivistët më të flaktë, kishin punuar derë më derë e gjithë natën, në mënyrë që të sigurohej një pjesëmarrje sa më e madhe. Në mëngjes, 100 mijë veta, me komunistët më fanatikë e punonjësit civilë të Securitate (Sigurimi i Shtetit Rumun), në ballë, ishin mbledhur për t'i shprehur edhe një herë besnikërinë shëfit të madh. Ndërkohë, televizioni, kish marrë masat e duhura për transmetimin direkt të manifestimit popullor.

Aty rreth orës 13:00, Çaushesku nisi leximin e fjalimit, me një

regjistër zëri të qetë e të ulët. Por, pikërisht në ato çaste, ndodhi ajo që nuk parashikohej. Një pjesë e madhe e turmës nisi të murmurijë nenë zë, duke lëshuar një “u” të gjatë kundërshtuese. Me një lëvizje të dorës, Çausheku, u mundua të qetësojë turmën. Por, kjo nuk pati sukses. Pastaj, ai hodhi sytë përreth pa folur, me pamje të shtangur e pa jetë. Dikush, përbri tij, iu afrua e i tha pranë veshit: Sigurimi po vjen! Fjalë, të cilat, edhe pse të shqiptuara me zë të ulët, u dëgjuan nga turma, nëpërmjet mikrofonit kryesor. Në atë çast, televizioni ndërpreu transmetimin. Por, pa kaluar pak sekonda, figura e Çaushekut u duk sërish në ekran. E shoqja, Elena, iu afrua e i tha diçka nënë zë. Pas kësaj, diktatori, si një automat nisi t’i drejtohet turmës me një “litani” premtimesh, për rritjen e rrogave të punëtorëve e kompensimeve për familjet e tyre. Ndërkohë, së largu, drejt sheshit, u dukën të vijnë tanket e nisën të dëgjohej krisma armësh ...

Ajo që ndodhi atë ditë në Bukuresht, tregoi qartë se dhuna e shtypja ndaj popullit kish arritur kulmin. Por, hija e frikshme e Çaushekut s’trembte më askënd. Gjatë 24 orëve që pasuan, u duk qartë se pushteti i tij po shpërbëhej. Në rrugët e kryeqytetit nisën përlëshjet e policisë me manifestues të moshave të ndryshme. Më pas, në orët e mbrëmjes, disa mijëra demonstrues okupuan sheshin para universitetit, duke ngritur barrikada e duke u venë zjarrin shumë autobusave e veturave. Aty rreth orës 23:00, radioja dha lajmin se gjenerali Milea, ministër i Mbrojtjes, kish vlarë veten.

Më pas ngjarjet precipituan. Ushtarët, të bashkuar me manifestuesit, u nisën drejt Komitetit Qendror, ku qe strehuar Çausheku me bashkëpunëtorët e tij. Turma shpërtheu dyert e hekurta e u derdh drejt hyrjes qendrore por, në ato çaste, të gjithë shtangën kur panë që nga tarraca e ndërtesës së Komitetit Qendror u ngrit një helikopter i bardhë, i cili, pasi bëri një fluturim rrotull, u nis në drejtim të veriut.

Një orë më pas, televizioni dha lajmin se Çausheku me Elenën ishin arrestuar pranë qytetit Tirgoviste, në veriperëndim të Bukureshtit. Më vonë, në mbrëmjen e 25 dhjetorit, televizioni transmetoi kronikën e procesit gjyqësor – ushtarak – të çiftit Çausheku, si edhe pamjet e pushkatimit e më pas, të varrosjes së shpejtë të kufomave të tyre.

Ashtu si gjithë bota, edhe shqiptarët, nëpërmjet lajmeve e kronikave të radiove e televizioneve të huaja, ndoqën hap pas hapi ngjarjet rrëqethëse në Rumani. Ata u benë dëshmitarë të përmbysjes së një diktature, e cila qe po aq e egër sa edhe ajo e Tiranës. Në fakt, ngjashmëritë midis tyre ishin



vërtet mjaft të mëdha. Të dy popujt ishin ballkanas. Me histori, tradita, psikologji e mentalitete të ngjashme. Po ashtu, me sisteme, ideologji e diktatorë të njëjtë. (Enveri, edhe pse i vdekur, fantazmën e kishte ende shumë të frikshme. Bile, edhe më tepër se ajo e Çaushekut të gjallë. Nga ana tjetër, vejusha e tij, Nexhmija, qe një shëmbëlltyrë edhe më e keqe e ligësisë, arrogancës dhe krimeve makbethiane të Elenës. E, së fundi, Securitate rumun, ish-vëlla siamez me Sigurimin e tmerrshëm shqiptar ...).

Ndërkohë, nisën pëshpëritjet. Natyrisht, me ndrojtje, dyshim, frikë por edhe me shpresë. Kush e kish radhën, tani, pas Bukureshtit? A do të mbyllej, vallë, efekti domino në Lindje, me rrëzimin e Tiranisë në Tiranë...?

...Në një bisedë me Ramiz Alinë, vetëm disa ditë mbas pamjeve televizive që paraqisnin fundin tragjik të Çaushekut e bashkëshortes Elena, shefi foli: Ne e kishim parashikuar me kohë fundin e “Çaushit”. Vetë e zgjodhi rrugën revizioniste duke u larguar nga marksizmi! Mu dukën jo fort të natyrshme e bindëse ato lloj konkluzionesh. Megjithatë e pyeta: Në gazetë do të bëjmë ndonjë shkrim për këto ngjarje? S’ka pse të prononcohem. Asgjë nuk na ka lidhur e nuk na lidh me të. Ne kemi rrugën tonë. Ashtu apo jo ...?!

Në fakt, ajo siguri e qetësi në dukje, qe njëra anë e medaljes. Rënia e regjimit autoritar në Rumani e fundi i Çaushekut, shkaktuan panik në radhët e udhëheqjes së lartë, duke u dhënë zemër aksioneve antikomuniste në vend. Por, megjithatë, regjimi, ashtu si struci, s’donte të besonte se fundi i tij qe fare pranë dhe i pashmangshëm.

Në janar 1990, në disa lagje të

Tiranës u shkruan parullat e para, “Enver – Hitler”, “Poshtë komunizmi”, “Duam liri”, të shoqëruara me trakte ku bëhej thirrje për përmbysjen e regjimit. Ndërkohë, në Shkodër, u organizua një demonstratë popullore ku, grupe të rinjsh, u orvatën të rrëzonin bustin e Stalinit. Sigurimi ndërhyri me dhunë, duke bërë arrestime të shumta. Më pas, në shkurt, në kryeqytet, pëshpëritej fshehtas për organizimin e një manifestimi antikomunist, i cili do të mbahej në sheshin Skendërbej. Njerëzit, po lëvizin e po shfaqin hapur e pa frikë, revoltën e pakënaqësitë...!

I trembur, regjimi nisi të ndryshojë taktikë. Herë me kërcënime e herë me lëshime. Qe pikërisht në një situatë të tillë që nisi të flitej për reforma në demokratizimin e jetës e përsosjen e legjislacionit socialist. (Për mbrojtjen gjatë proceseve gjyqësore, reformimin e sistemit juridik, lirin e të burgosurve politikë etj.). Sipas orientimeve të reja, të gjitha këto parashikohej të shoqëroheshin me një zhvillim të mëtejshëm të shkëmbimeve me vendet e huaja, shoqëruar dhe me ripërtëritjen e forcave lëvizëse të prodhimit socialist.

Por, Plenumi i IX-të i Komitetit Qendror (janar 1990) qe ogurzi edhe pse, herë-herë, zbutja e toneve të tij s’qe veç klithma e fundit e dëshpërimit. Sipas filozofisë së tij, ngjarjet në Lindje s’kishin asgjë të përbashkët me popullin shqiptar e se ... borgjezia ndërkombëtare synonte që, ngjarje kundërrivolucionare të njëjta si ato që zhvilloheshin në ato vende, të ndodhin dhe tek ne.

Megjithatë, për të dalë nga situata e për të krijuar një imazh tjetër, ish e domosdoshme të ndërrohej taktikë. Qe e nevojshme të bëheshin disa

meremetime, të cilat, sipas logjikës së Partisë, jo vetëm që do shërbenin për qetësimin e gjendjes në vend, por edhe do të amortizonin sulmet e borgjezisë ndërkombëtare e cila, po bënte të pamundurën për të ndërsyer popullin në trazira e rrëmuja.

Më mars, Ramiz Alia premtoi publikisht se proceset demokratike të nisura në vend ishin të pakthyeshme. Në prill, në gazetën Zëri i Popullit u botua shkrimi Në kërkim të kohës së humbur i prof. Ylli Popës, i cili bënte thirrje për ndryshime duke njohur gabimet e së kaluarës. (Pjesa më e madhe e lexuesve i përkrähën idetë e tij, por s’qenë të pakët ata që iu drejtuan me letra Komitetit Qendror, për denoncimin e përmbajtjes së tij kundër – revolucionare).

Po në prill, në një fjalim tjetër, Ramiz Alia deklaroi se, në fushën e bujqësisë lypset të jetë vetë fshatarësia ajo, e cila duhet të gjykojë e të vendosë për rrugët dhe mënyrat e furnizimit të saj, ndërkohë që nga Ministria e Bujqësisë nisën të dërgohen orientime të reja për zgjerimin e oborreve, mbajtjen e bagëtitve, inkurajimin e prodhimeve për tregun privat etj.


Në maj 1990, në materialet e brendshme të Partisë e më pas në shtyp, nisi të flitej lidhur me rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike me BRSS-në e ShBA-në. Po atë muaj, Kuvendi Popullor abrogoi ligjin famëkeq 55 për agjitacion e propagandë, si edhe atë të propagandës fetare. (Me rastin e vizitës së sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Perez de Kuelar, Ramiz Alia deklaroi se besimi fetar qe çështje personale e ndërgjegjes së çdo individi).

Ndërkohë, u njoftuan një varg masash të tjera për thellimin e demokratizimit të jetës në si, rihapja e Ministrisë së

Drejtësisë, paisja e qytetarëve me pasaporta udhëtimi për jashtë, heqja e cilësimit të arratisjes si tradhti ndaj atdheut etj. Po ashtu, regjimi nisi të interesohej dhe për anëtarësimin në Konferencën për Sigurimin e Bashkëpunimit Evropian si edhe për nënshkrimin e Akteve të Konferencës së Helsinkit.

Reformat spektakolare deklaroheshin, po njerëzit s’shihnin ndryshime. Sigurimi vazhdonte arrestimet, ndërkohë që Partia në mbledhjet të fshehta, deklaronte se pushtetin e kishte fituar me gjak e do ta mbronte po me gjak. Pra, çdo gjë ish demagogji! Premtimet e Ramiz Alisë qenë sa për të hedhur hi syve. Në rrethana të tilla, tensioni në vend u rrit më tepër. Në Kavajë plasën trazira e përlëshje me policinë. Pastaj, të tilla, pati edhe në Tiranë. Në 1 e 2 korrik, ambasadat në Tiranë u pushtuan nga mijëra qytetarë. Në tetor, Ismail Kadare, kërkoi strehim politik në Francë. Situatat ndryshonin me ditë. Vendi ziente e pritej të shpërthente.

Regjimi qe në buzë të greminës e po merrte rrokullimën drejt fundit të pashmangshëm. Në ditët e para të dhjetorit plasën protestat e studentëve. Në datën 12 të po atij muaji (12 dhjetor 1990), u krijua Partia Demokratike, partia e parë opozitare antikomuniste, e cila shënoi edhe fillimin e epokës së pluralizmit politik në Shqipëri. Në 20 shkurt 1991, mes lotëve, gëzimit e thirrjeve të popullit për Liri e Demokraci, u rrëzua dhe u hoq zvarrë nëpër rrugët e kryeqytetit, monumenti i diktatorit të urryer, Enver Hoxha. Ky qe edhe fundi i natës e lëngatës së gjatë totalitare. Akti i fundit i tragjedisë rrëqethëse së një populli. Për shqiptarët po niste një epokë e re ...! /Memorie.al/



## Ballkani sot luan kundër Slavia Praha

PRISHTINË, 25 TETOR (ER) - Ballkani - Slavia Praha të zhvillohet sot (e enjte) në stadiumin "Fadil Vokrri" me fillim nga ora 21:00. Klubi nga

Suhareka synon të fitojë këtë ndeshje e cila është mjaft e rëndësishme në kuadër të Conference League. Ballkani ishte mposhtur 3:2 nga Slavia

Praha më 15 shtator. Ballkani dhe Slavia Praha janë në Grupin G dhe kanë nga 4 pikë. Për këtë takim tashmë janë caktuar gjyqtarët. Morten

Krogh i Danimarkës do të jetë gjyqtar kryesor, ndërsa do të asistohet nga Rasmussen dhe Dahl. Gjyqtari i katërt në këtë duel do të jetë Mikkell Redder.



## Presidenti Ademi paraqet projektet e FFK-së në Komitetin HatTrick

Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, në Frankfurt të Gjermanisë ka paraqitur projektet e kësaj federate për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së futbollit në vendin tonë. Ademi në Komitetin HatTrick të UEFA-s ka kërkuar përkrahjen e anëtarëve të këtij komiteti, duke theksuar rëndësinë që rinisë së Kosovës t'i krijohen mundësitë dhe hapësirat e nevojshme për ta zhvilluar talentin e tyre në futboll

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, është duke marrë pjesë në mbledhjen e radhës të Komitetit HatTrick të UEFA-s, i cili është duke u mbajtur në Frankfurt. Gjatë këtij takimi Ademi ka paraqitur projektet dhe nevojat financiare për infrastrukturë, për edukim e zhvillim, për futbollin e femrave dhe për "Grassroots". Në adresimin e tij para anëtarëve të tjerë të Komitetit HatTrick, presidenti i FFK-së ka bërë paraqitjen e projekteve të përbashkëta me komunat, me theks të veçantë për projektin në kryeqytet, ku do të bëhet

Kompleksi i Sportit të kryeqytetit e ku parashihet të jetë edhe një stadium tjetër i kategorisë së katërt të UEFA-s si dhe disa fusha ndihmëse. Pjesë e këtij kompleksi parashihet të jetë edhe një palestër multifunktionale, e cila do të jetë edhe në shërbim të klubeve të futbollit si dhe për ekipet kombëtare të futbollit. Për herë të parë presidenti Ademi ka paraqitur edhe projektin e energjisë eficiente dhe atë të shëndetësisë sportive. Më tutje, Ademi ka paraqitur projektin për vazhdimin e ndërtimit në Kampin Nacional në Hajvali, ku do të ndërtohet edhe një fushë e mbyllur me standardet e UEFA-s, e ku do të mund të stërviten ekipet



kombëtare gjatë periudhës së dimrit. Gjatë paraqitjes së tij presidenti i FFK-së ka paraqitur edhe një projekt të veçantë për mirëmbajtjen e stadioneve dhe objekteve sportive, teksa ka shpalosur edhe fillimin e projektit të Kampit në Obiliq, pastaj projektin shumetnik në Kishnicë, projektin e Karantinës së Ekipëve Nationale në Batllavë, si dhe të shtëpisë për rehabilitimin e futbollistëve (sportistëve) pas operimeve ose lëndimeve. Gjithashtu, Ademi ka paraqitur edhe një marrëveshje që do të funksionalizohet me Institutin e Mjekësisë Sportive në Orllan, për

të cilën ndërtesë është bërë kërkesa te kryetari dhe Asambleja e komunës së Podujevës. Një tjetër projekt shumë atraktiv, i cili është paraqitur para Komitetit HatTrick, është edhe ai në parkun e Gërmisë, të cilin presidenti i FFK-së e ka vlerësuar projekt sportivo-ekonomik, e nëpërmjet të cilit kryeqyteti i Kosovës do t'u japë mundësi rinisë për aktivitete sportive. Si projekt i rëndësishëm së veçantë është paraqitur edhe krijimi i Kolegjit të Futbollit, kurse si projekt shumë i rëndësishëm është edhe ai i përzgjedhjes së 50 trajnerëve të rinj të Kosovës, të cilët do ta ndjekin edukimin

nëpër klubet e ligave evropiane dhe më pas përvijën e fituar do të kthehen ta instalojnë në futbollin vendor.

Të gjitha projektet e paraqitura në Komitetin HatTrick, duke përfshirë edhe specializimin e administratës në kurset e UEFA-s, janë përfshirë në Strategjinë e FFK-së për pesë vjetet e ardhshme. Presidenti Ademi ka raportuar edhe për projektet e realizuara me komunat dhe ato që janë të parapara për t'u finalizuar, teksa ka theksuar se çdo komunë që bën memorandum me FFK-në do ta ketë mundësinë e ndërtimit të fushave stërvitore. Në fund, presidenti i FFK-së ka kërkuar përkrahje nga anëtarët e tjerë të Komitetit HatTrick për të gjitha projektet e FFK-së, duke theksuar rëndësinë që rinisë së Kosovës t'i krijohen mundësitë dhe hapësirat e nevojshme për ta zhvilluar talentin e tyre në futboll. Ai ka theksuar se Kosova është me fat që ka rini shumë të talentuar dhe kjo po dëshmohej si në vendin tonë ashtu edhe në çdo vend të Evropës dhe botës ku jetojnë e veprojnë bashkatdhetarët tanë.

## Komuna e Prishtinës jep 20 bursa me nga 1 000 euro për shpresat e sportit në kryeqytet



Prishtinë, 26 tetor (ER) - Komuna e Prishtinës ka vendosur t'i përkrahë financiarisht sportistët e rinj të kësaj komune. Drejtoria e Sportit pranë komunës së Prishtinës ka njoftuar të mërkurën se i ka dhënë 20 bursa me nga 1 000 euro për 20 shpresa të sportit të kryeqytetit. "Në ambientet e komunës së Prishtinës kemi

pritur 20 të rinj e të reja të cilët janë shpresat e sportit të kryeqytetit. Për ta stimuluar punën dhe angazhimin e tyre, por edhe për t'u dëshmuar se si drejtor i Sportit do të jem afër tyre në secilin hap drejt ndërtimit të një karriere prej kampioni, i kemi ndarë secilit bursë vjetore prej 1 000 eurosh. Si ish-sportist e di dhe e kuptoj rëndësinë e

mbështetjes për të cilën ka nevojë një i ri ose e re në fillim të karrierës. Prandaj të gjithë këta, por jo vetëm këta, edhe shumë e shumë sportistë të tjera të ri të Prishtinës, në rrugëtimin e tyre për t'i prekur majat e sportit, do të më kenë krahë në çdo moment", ka shkruar në "Facebook" drejtori për Sport në komunën e Prishtinës, Granit Rugova.

## Dukagjini fiton kundër Llapit

Podujevë, 26 tetor - Dukagjini e ka regjistruar një fitore të madhe të mërkurën në ndeshjen e mbetur të xhiros së 12-të të Superligës së futbollit.

Klinasit e kanë mposhtur Llapin me rezultat 1:0 në udhëtim. Skuadra nga Klina ka festuar falë golit të realizuar në pjesën e dytë nga Iljasa Zylfiu. Llapjanët i

kanë pasur disa raste shënimi dhe e kanë humbur edhe një penallti me Gerhard Prognin, gjuajtjen e të cilit e ka pritur portieri Kenan Haxhihamza.

Kjo ishte fitorja e tretë sezonale e Dukagjinit, i cili gjendet në pozitën e tetë në tabelë. Kurse Llapi është i gjashti në tabelën e ligës elitare.





**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "TSF Global" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811910224 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "TSF Global" L.L.C. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811910224 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "TSF Global" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811910224 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 26.10.2022 bënë shpallje publike:

**NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-22-06**

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e fushës së futbollit - Kishnic  
Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë  
Numri i ofertave të pranuar: 1(një)

**ME KONTRATË SHPËRBLEHET**

FC Hajvalia me çmimin 506.00 euro me TVSH.

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 31.10.2022 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku industrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 date 11.01.2021.

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "May Kosova Energy" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811933367 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "May Kosova Energy" D.O.O. Pristine, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811933367 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform al customers that the limited liability "May Kosova Energy" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811933367 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Aris-Golden Hands SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330344044 pronar Selver Halili Malishev-Gjilan.

- Azem Shala shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Rexhep Shaipi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Dy Dëshmorët" Piranë.

- Muharem Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Imran Maqkaj shpall te pavlefshme diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

- Afrim Badalli shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



**ANNOUNCING THE 2017  
QUALITY & SALES AWARDS**

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales